REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.4629 Prot Maliq, më 27.07.2026

VENDIM
Nr. 92, datë 24.07.2026

"Për miratimin e proces verbalit të datës 25.06.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 8, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 88, i Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 25.06.2026 bashkangjitur.

2.Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 27.07.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 25.06.2026 Prot.56 (pesëdhjetëegjashtë)

Protokoll nr. 56

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (29.05.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2026";
5.P-V"Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit për mbulimin e shpenezimeve të varrimit";
6.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim";
7.P-V "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi";
8.P-V "Për miratimin e Raportit të Konsoliduar për bashkinë Maliq viti 2025";
9.P-V "P-V "Për fillimin e procedurave për vënien në dispozicion të truallit për ndërtimin e zyrës së marrdhënieve me konsumatorët nga ujësjellës kanalzime Korçë";
10.P-V "Për një ndryshim në VKB-në nr.73 datë 29.05.2026 për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit Pallati i Kulutës , "Dhimitër Orgocka";
11.P-V "Për indetifikimin e pasurisë shënuar me X në fshatin Selcë Nj.A Gorë";
12.P-V "Për përditësimin dhe saktësimin e regjistrit kombëtar të adresave dhe saktësimin e kufijve territorial në Njësi Admimistrative (rendi 4) dhe kufi fshati (rendi 5)";
13.P-V "Për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Maliq";
14. Zgjedhja e përfaqësuesit të Këshillit Bashkiak Maliq në Këshillin e Qarkut Korçë pas vakancës të krijuar.
15.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Dritan Çami; Floreta Zaçe; Marinathi Avrami; Idlir Limllari; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi;Enida Avdolli; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Eglantina Balli; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Eglantina Balli; Server Xhuti; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; 21(njëzetëenjë) këshilltarë.

Mungesa: Rovena Terolli; Klea Baçi; Eriseld Jonusllari; Xhuana Hoxhallari; Dalina Krekas; Albina Xhejo; Andonaq Risto;Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Faslli Zholi; 10 (dhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Përjgejgjës i Auditit të Brendshëm;z,Afrim Beqiraj; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula; Drejtore e Kulturës; znj.Dhora Shkembi; Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli; Përgjegjese Zyre pranë Drejtorisë së Shërbimit Social;znj.Johana Hoxha;

Ornildi Demollari: Mirë, fillojmë. Mirëdita të gjithëve. Të nderuar kolegë, i nderuar kryetar i Bashkisë, të nderuar pjesëmarrës, po fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë së Maliqit. Përpara se të ecim me rendin e ditës dhe me pikat, bëjmë një verifikim të korumit. Korumi realizohet pasi në sallë ndodhen 20 këshilltarë, kështu që mund të vijojmë me rendin e ditës. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por në ndryshim nga kjo që ju keni përpara, do të shtojmë edhe disa pika me mirëkuptimin tuaj, sigurisht. Janë disa materiale që na kanë erdhur pak më mbrapa, siç është një material për një aktivitet kulturor që quhet "Verde Portokalli", është një aktivitet tjetër kulturor që quhet "Kënga e Madhe", një tjetër aktivitet që quhet "Netët e Mallit". Dhe pika e katërt që i propozoj Këshillit për ta shtuar në rendin e ditës ka të bëjë me emërtimet e institucioneve. Është një material që vjen si propozim i Komisionit të Dhënies së Titujve, edhe ky na ka erdhur pak me vonesë. Kështu që rendit të ditës do t'i shtojmë edhe këto 4 pika me mirëkuptimin tuaj. E kalojmë në votim duke shtuar edhe këto 4 pika, kush është?

Yllson Ibrahimllari:Përshëndetje, në emër të grupit të këshilltarëve të opozitës, do të mendoja që të mos sjellim më problematika në mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit, që të përcaktojmë cilat janë emergjente dhe cilat nuk janë. Duke tentuar të zbatojmë rregulloren, është mbledhja e fundit që po lejojmë që të kalojnë pika që s'kanë marrë miratimin e komisioneve respektive. Ftoj të gjithë kolegët këshilltarë që besoj një ditë në muaj ja kanë detyrim, as qejf mbetjeve me kryetarin e Bashkisë për pozicionimin në listën konkurruese kur i vjen puna për t'u bërë këshilltar, as ne të opozitës në atë krah, duhet që më patjetër të gjitha materialet të kenë kaluar në komisionet respektive të Këshillit. Sot po miratojmë, japim OK-në për këtë mbledhje, tani besoj që kaq përkushtim ja kemi që të bëjmë edhe atë kalendarin e zakonshëm të pushimeve nëse doni që të mos ja u prishim për mungesë korumi. Faleminderit.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim? ju lutem, kush është dakord me 4 shtesat?20 vota pro. Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka, miratohet rendi i ditës me 4 shtesat të cilat përmenda pak më përpara. Ju lutem, dua t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, të cilat janë gjithsej, janë 14 projektvendime të cilat janë kthyer në vendime, 9 me karakter normativ dhe 5 me karakter kolektiv të cilat janë kthyer në vendime tashmë. Ju besoj i keni përpara, kështu që nuk është e nevojshme t'i lexoj. Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar, një procedurë standarde, kush është dakord me protokollin? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet protokolli, faleminderit. Tani sipas rendit të ditës kalojmë tek pika tjetër. A më falni, më lejoni t'ju rikujtoj edhe njëherë deklarimin e konfliktit të interesit nga këshilltarët. Nëse ndonjë nga ne ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës, është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutim dhe as në votim. Faleminderit. Kalojmë tek pika 4 e rendit të ditës që është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2026. Komisioni përkatës, po?

Gentiana Drabo:Përshëndetje. Në mungesë të kryetarit të komisionit do t'i thashë t'thëni, komisioni ka dakordësuar për miratimin e ndihmës ekonomike masën 6%, ftojmë Këshillin që ta miratojë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë koment? E kalojmë në votim pikën 4?
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet pika 4, faleminderit. Kalojmë tek pika 5 e rendit të ditës që është projektvendim për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit për mbulimin e shpenzimeve të varimit.

Gentiana Drabo: Edhe për këtë pikë komisioni ka dakordësuar. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë gjë tjetër këtu, ndonjë pyetje, ndonjë koment? E kalojmë në votim atëherë? kryetar kishe gjë për të shtuar, e kalojmë në votim,
Kush është dakord? 20 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka, miratohet pika 5, faleminderit. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës që është projektvendim për miratimin e përfituesve nga programi "Subvencionimi i interesave të kredisë për strehimin". Komisioni? Idlir?

Idlir Limllari: Janë dhënë 3 kredi për 3 familje. Dy janë në familje të reja, njëra është me kemp. Jemi dakord që t'i marrin ato kreditë.

Ornildi Demollari: Kryetar kishe gjë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndoshta ka një apel për familjet të cilat kanë nevojë, është një mënyrë që ata mund të lehtësohen me kushtet lehtësuese të kredisë, kështu që edhe kjo le të jetë një apel për qytetarët të cilët kanë nevojë për strehim të bëhen pjesë e saj. Ne bashkë me

fondet të çelura, nuk janë fondet tona, janë fondet e qeverisë. E i vëmë në dispozicion dhe zyra përkatëse e strehimit, rast pas rasti do i ndihmojë për plotësimin e dokumentacionit dhe për plotësimin e kritereve që ata duhet të realizojnë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë paqartësi? E kalojmë në votim atëherë, kush është dakord? 20 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka, me të gjitha votat miratohet, faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës që është projektvendim për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për harkun kohor 2027-2029 në nivel programi.

Petrit Kupe:Ky projektvendim bën fjalë për miratimin e programit buxhetor. Është një parashikim që bëhet nga Drejtoria e Financave, në lidhje me të ardhurat në vitet 2027-2029, por gjithashtu edhe me shpenzimet. Ky program paraqitet pranë Ministrisë së Financave për të bërë të mundur financimin e këtyre fondeve. Prandaj ne jemi dakord që të miratohet, sepse e shohim që edhe të ardhurat, edhe shpenzimet nga viti në vit parashikohen me një rritje, me rritje të ndjeshme, gjë që parashikon dhe rritje të shërbimeve në bashki.

Ornildi Demollari: Dakord, kemi ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim, kishe?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një procedurë standarde, që e shpjegovi edhe parekomisionit të Financës, një procedurë ligjore që e kemi detyrim për të. Ne e kemi çuar gjithë informacionin në Ministrinë e Financave në miratimin paraprak që ju i keni realizuar si Këshill, tavaneve përgatitore, edhe pse ato përcaktohen me vendim qeverie. Ne bëjmë përllogaritjet e duhura nga njëri vit tek tjetri, pavarësisht se këto s'janë definitive se kur vjen buxheti vjetor ato finalizohen përfundimisht realisht me vlerat që çelen nga qeveria, miratohen nga parlamenti dhe ne përcaktojmë si buxhet të pavarur dhe ato përbëjnë pjesën e buxhetit pastaj vjetor dhe 3-vjeçar të bashkisë sonë. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë në votim apo kemi ndonjë gjë tjetër? Kush është dakord?
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, me të gjitha votat miratohet, faleminderit. Kalojmë tek pika 8 e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e raportit të konsoliduar për Bashkinë Maliq viti 2025.Mbledhjes i bashkohet dhe Këshilltari z.Armando Dautllari, shkon në 21 numri i Këshilltrave të pranishëm në sallë.

Petrit Kupe:Ky projektvendim bën fjalë për miratimin përfundimtar të konsoliduar të veprimtarisë së Bashkisë së Maliqit për vitin 2025. Është një projektvendim që merr rrugë mbas miratimit në Këshillin e Bashkisë brenda afateve, i cili duhet të, brenda muajit maj duhet të miratohet nga Këshilli i Bashkisë. Bën fjalë për të gjithë aktivitetin financiar të Bashkisë për vitin 2025, si për të ardhurat, për shpenzimet, ashtu edhe për investimet. Përgjithësisht treguesit

janë pozitivë, gjë që flet për një ecuri të vazhdueshme në realizimin e të ardhurave, në realizimin e investimeve, domethënë në realizimin e premtimeve të dhëna. Për më gjerë, domethënë me shifra mund të flasë përfaqësuesi i Bashkisë që e ka miratuar programin, Afrimin.

Ornildi Demollari: Kryetar kish gjë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është e vërtetë, ky është raporti i konsoliduar financiar për vitin 2025. Ne kemi paraqitur pothuajse të gjitha shpenzimet dhe realizimin e të ardhurave sipas llogarive buxhetore, që nga pagat, shpenzimet operative, investimet. Ka një rritje të realizimit të buxhetit të pavarur krahasimisht me një vit më parë, nga 57 në 62%. Realizimet e tjera për mua kapin shifrat konsiderueshme, si në paga, si në shpenzime operative, si në investime. Pavarësisht se në investimet nuk jemi në nivelin e duhur për efekt të përqindjes, por në fakt janë investime në proces, të cilat jo vetëm që finalizohen në fillim të vitit 2026, por disa janë edhe me efekte 3-vjeçare. Por tek e përgjithshmia kemi një raport të konsoliduar pozitiv, por ajo çfarë e ngremë gjithmonë nga njëri vit te tjetri ka të bëjë me rritjen e performancës në lidhje me mbledhjen e taksave dhe tatimeve, dhe të shpresojmë që 2026-ta të jetë më lartë se 2025-ta. Ne ju kemi shpjeguar realizimet të ndara në të ardhura tatimore, jo tatimore, në totalin e bashkisë. Po të shikoni, realizimi për pagat kap vlerën 91%, shpenzimet operative 98%, dhe jo se ne nuk i kemi finalizuar 100%, se ato në një farë mënyre janë realizuar 100%, por ka për efekt të vendeve bosh në pozicione, për efekt mosrealizimi. Shpenzimet operative 87. 7%, një shifër e konsiderueshme. Dhe siç e thashë, edhe investimet, po ta shikoni, janë 95. 1%, një shifër shumë e lartë, krahasimisht edhe me institucionet tjera të cilat ndonjëherë në këtë pikë janë më dobët, pasi janë pak më të vështira se shpenzimet standarde, të themi paga dhe sigurime, që në një farë mënyre nuk kanë ndonjë problematikë. Edhe për aktivet nuk kemi ndonjë problem. Në qoftë se ka ndonjë pyetje, unë jam i gatshëm t'ju dëgjoj. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit kryetar. Kemi ndonjë pyetje këtu? Tek raporti i konsolidimit? E kalojmë në votim atëherë, kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, me 21 vota pro miratohet, faleminderit. Kalojmë tek pika 9, që është projektvendim për fillimin e procedurave për vënie në dispozicion të truallit për ndërtimin e zyrës së marrëdhënieve me konsumatorët nga ujësjellës kanalizime Korçë.

Petrit Kupe:Kërkohet nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve që të kryhet verifikohet dokumentacioni ligjor pranë ASHK-së të pasurive që preken për zbatimin e projektit. Siç dihet, zyra e ujësjellës kanalizimeve është në një ambient me qira. Ata kanë kërkuar që të ndërtohet një zyrë definitive dhe nëpërmjet projektvendimit i hapet rrugë procedurës së kryerjes së verifikimit të këtyre pronave. Besoj se mbas kësaj do të bëhet një vendim për përfundimtar për miratimin e kësaj sipërfaqe ku do të ndërtohen këto zyra. Kaq është për sot, vetëm fillimi i procedurave, pastaj më vonë vendimi tjetër.

Ornildi Demollari: Po, ndonjë pyetje tjetër ka? Po?

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, në këtë projektvendim dhe në disa projektvendime tjera që shoh, besoj që del e nevojshme edhe një prononsim nga zyra urbanistikës që kemi, që duhet të sjellë një relacion gjithnjë përveç kësaj zyre së pronave dhe aseteve. Dhe ndërkohë, për neve, sa na takon ne si këshilltarë, mund të shkojë dhe në 2-3 komisione një projektvendim. Në rastin konkret, gjej për ta sqaruar dhe për ta shtjelluar deri diku, duhet të ishte dhe tek Komisioni i Zhvillimit Hapësinor që drejtohet nga inxhinieri Ildir Limllari. Ta kemi parasysh në të ardhmen, faleminderit.

Ornildi Demollari: Kryetar, mund ta shpjegoni siç duhet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani, unë dua të shpjegoj një moment. Vetë Bashkia e Maliqit është aksionere e ujësjellësit të Korçës, me përqindjen e aksioneve të përcaktuara në bazë të saj. Normalisht, sot shërbimi ndaj qytetarëve kryhet në disa ambiente me qira, në ambiente jonormale, dhoma të vogla, etj. Dhe ne, në kuadër dhe të krijimit të institucioneve pranë qytetit të Maliqit, siç kemi bërë vit pas viti, unë e mendoj që edhe kjo është një risi tjetër, që ne, jo vetëm për shërbim të mirë ndaj qytetarëve, por dhe për prezantim dinjitoz, duhet të ndërtojmë një, dhe propozimi ka ardhur nga ndërmarrja e ujësjellësit "Sha Korçë", ku ne jemi aksioner, për 500 metra truall, në një vend që është truall i bashkisë, në zonën e ku kemi bërë dhe zyrën arsimore, që edhe ambienti i stabilizohet, edhe në një farë mënyre largojmë edhe një amulli që e kemi në atë zonë, për efekt të pazarit, që duam ta bëjmë, ta spostojmë në një vend më lart dhe aty të ketë edhe një parkim, edhe të vijnë njerëzit për të paguar edhe tarifat, edhe të shpresojmë që aty do të paguhen edhe taksat dhe tatimet, ku bashkia i ka kërkuar që të kthehen ata agjentë tatimorë për neve. Kështu që unë mendoj është një diçka pozitive, që ata duan të investojnë me fondet e ujësjellësit, për të ndërtuar një ambient sa më modern. E kanë sjellë një projekt ide tek ne. Ka qenë një projekt i vlerësuar dhe nga zyra e urbanistikës, ku ka të drejtë doktori për këtë qëllim, por s'ka asnjë problem që edhe këshilltarë, komisionet, le të jenë palë për disa vendimmarrje, të cilat ndonjëherë ndërthurin njëra-tjetrën. Unë mendoj që duhet ta miratojmë dhe të shikojmë pastaj efektet, pjesën ligjore, deri në dhënien e lejes së ndërtimit, për efekt të asaj çfarë folëm lart. Por ne e kishim detyrim për të ardhur këtu, pasi vetëm Këshilli ka të drejtë që t'i japë prona për subjekte, ndoshta edhe për bashkinë, për qëllime të tjera. Nuk e ka këtë autoritet askush tjetër.

Ornildi Demollari: Kemi ndonjë gjë këtu? E kalojmë në votim atëherë, kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet pika 9, faleminderit. Kalojmë tek pika 10 e rendit të ditës, që është projektvendim për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë me numrin 73, datë 29. 05. 2026, për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës Dhimitër Orgocka Maliq".

Petrit Kupe:Është gati i njëjti projektvendim me të parin, por për këtë rast është marrë dhe një vendim nga ana e Këshillit të Bashkisë. Me sa duket kërkohet të plotësohet dokumentacioni për

këto lloj pronash që do të shpronësohen, për të vendosur numrat kadastralë, në mënyrë që të vazhdojë procesi i shpronësimit të këtyre pronave përreth Shtëpisë së Kulturës, ashtu siç e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e mëparshme. Kështu që ne jemi okej.

Ornildi Demollari: Po?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ka një plotësim të vendimit të mëparshëm, pasi na ka dalë një problematikë. Në qoftë se në mbledhjen e parë kemi marrë një vendim për shpronësim të një pasurie me një fraksion 1. 51, për 530 metra katrorë, brenda në kufijtë e Pallatit të Kulturës, por brenda oborrit të shkollës së mesme, kemi edhe një sipërfaqe rreth 300 metra katrorë, e cila është kthyer me vendim gjykate. Ne jemi duke, edhe unë ndoshta kemi debatuar, po zyra, zyra e pronave, të themi, po pasi kemi diskutuar edhe me urbanistikën, ndoshta do një rivlerësim nocioni. Titulli i vendimit, pasi kemi, kemi të bëjmë me dy objekte. Një objekt që i shërben Pallatit të Kulturës, ku ne kemi kthyer lulishte, dhe mendojmë që në një moment për efekt shpronësimi mund të bëjmë, jemi duke hartuar një projekt për një teatër veror në pjesën midis, pasi shpronësimi nuk mund të, nuk mund të bëhet vetëm për lulishte. Sipas Drejtorisë Shtetërore, Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve, që të shpronësohet për efekt të aktiviteteve kulturore, do të ketë dhe një objekt, të themi, paraprak që të ndodhë kjo. Dhe ndaj ne po punojmë që aty, zyra përkatëse po punon për një teatër veror, i cili do të bëjë të mundur për efekt qëllimit të kësaj pune. Dhe e dyta, pjesa 300 metra katrorë hyn në projektin e shkollës së mesme, për të cilën e kemi hartuar një projekt dhe momentalisht është hapur thirrja nga Ministria e Arsimit dhe ne e kemi futur në prioritetet tona disa shkolla midis, midis tyre dhe shkollën e mesme të qytetit të Maliqit, i cili nuk ka pësuar ndonjë ndërhyrje ndër vite, ku duam të ndërtojmë një palestër me të gjitha kushtet. Duam të ndërhyjmë në godinën ekzistuese për ta kthyer me ngrohje, me të gjitha aksesorët e duhur, si edhe qendra, shkolla kryesore e qytetit, por edhe e bashkisë, dhe për ta trajtuar gjithë territorin e oborrit të saj, të lulishtes, që çuditërisht nuk e di pse është kthyer. Janë këto nonsense se në Shqipëri, por në këto kushte jemi të detyruar që ne ta shpronësojmë, pronari të marrë lekët e tij ose e ka të drejtën e vet, dhe ne pastaj të kryejmë atë çfarë dhe po i paraprijmë kësaj. Dhe ndoshta unë mendoj që titulli i vendimit duhet të jetë për shpronësim për interes publik, për Pallatin e Kulturës Dimitër Orgocka dhe për shkollën e mesme Maliq, sipas dy projekteve që ne duam të zbatojmë. Se dua ta sqaroj në këtë moment.

Ornildi Demollari: Mendon që në zbardhje duhet ta ndryshojmë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në zbardhje, sekretari i këshillit me Drejtorinë e Urbanistikës ta precizojë këtë moment që të jemi sa më konçis, jo për shpronësim, se shpronësimi e ka efektin brenda, por për efekt të zbatimit të mëvonshëm të dy projekteve të cilat ndërthurin njëra-tjetrën.

Ornildi Demollari: Po.

Yllson Ibrahimllari:Në skicën shoqëruese ne i kemi të parashikuara të dyja këto që sapo e shpjegoi kryetari. Kështu që për ne të bëhet korrigjimi tek pjesa e vendimit, projektvendimit, të korrigjohet dhe pjesa e shkollës së mesme dhe jemi dakord për ta kaluar. Me këtë rast bëjmë edhe një gjë tjetër që tashmë fillojmë e funksionojmë, sepse një nga këto trashëgimtarët që shoh këtu është edhe përfaqësuese e njerëzve që i keni dhënë dhe titullin qytetar nderi ose krenaria e bashkisë. Kështu që në këtë rast ju falenderojmë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë në votim. Kush është dakord? 21 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka, miratohet me kushtin që në zbardhje të korrigjohet materiali. Titulli, domethënë. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, projektvendim me numër 11 për identifikimin e pasurisë shënuar me "X" në fshatin Selcë si njësi administrative "Gorë". Po, Idlir.

Idlir Limllari: Ky projektvendim nuk ishte shumë i qartë në këtë relacion dhe e lamë që ta diskutojmë këtu. Se nuk e kuptoj këtë, pse duhet ta vendosim neve këtë numrin ose kërkesën?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja ta shpjegojmë. Është i njëjti rast siç kemi miratuar një rrugë në fshatin Leminotë para disa mbledhjesh, që në hartat kadastrale figuron me "X", nuk figuron rrugë. Është marrë mendimi i banorëve aty dhe efektivisht aty ka patur dhe interesa për një rrugë pyjore, të themi, për banorët dhe duam t'i vëmë një numër kadastral kësaj rrugë, kësaj territori, kësaj pasurie që është "X", për t'u kthyer në rrugë, por kadastra nuk vepron në qoftë se ne nuk e çojmë me një vendim këshilli dhe nuk kemi probleme, të themi, me komunitetin apo me zonën.

Yllson Ibrahimllari: Me lejë?

Ornildi Demollari: Po.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, nga raporti që ka përgatitur kjo Drejtoria e Aseteve dhe Pronave në Bashkinë e Maliqit, dalin disa gjëra të paqarta përsa i përket këtij fenomeni. Tani unë dua të qartësoj pak kryetarin e bashkisë në këtë drejtim. Kjo bëhet fjalë për rrugën që lidh qendrën e Velçanit me fshatin Selcë, te Varreza të lartë, që shkon nga Velçani në Selcë. Që të vesh nga Velçani në Selcë, së pari duhet të ngjitesh në Velçan ose të jesh në Selcë e të kalosh nga Selca në Velçan. Pra, ne çfarë kemi sot? Ne kemi sot nga këtu ku jemi deri në Qesarak, lart te shtëpia e kryetarit apo tek shtëpia e Verës, çfarë rëndësi ka, më fal, nuk e kisha në konotacion negativist. Ne gjithë këtë rrugën e kemi pa numër, nga poshtë deri lart. Është një rrugë që është ndërhyrë në mënyrë si është ndërhyrë, s'po i hapim ato telashe, nga një firmë për ndërtimin e hidrocentralit italian që ngjiteshe në Lenije. Kjo rrugë në tërësinë e vetë, zoti Gerti i ka qenë në një udhëtim atje bashkë me ne të tjerët dhe përfaqësues nga Tirana. Atëherë, kjo rruga nga pjesa ku doli lumi kësaj radhe, siç doni të thoni ju, deri lart ose siç e keni konstatuar, është pa numër pasurie. Pjesa që i takon vetë fshatit Velçan ka një numër pasurie që është 753, kjo lista që themi ne. Ne në fakt po lidhim bregun e Selcës me fshatin Selcë, me argumentin që do të ndërhyjmë për pyjoren, etj. Ndërkohë që kemi dy kilometra rrugë nga poshtë për t'u ngjitur deri atje lart, që e kemi pa numër

pasurie dhe pa emrin rrugë. Ndërkohë që po të shikosh hartografikisht me gjendjen në terren, kemi hartën në vend tjetër dhe rrugën në vend tjetër, që do të thotë, jo për këtë rast, që do të thotë, nuk kemi saktësim hartografik. Është bërë një punë e mirë, unë besoj që ne këtë projektvendim ta kthejmë, ta plotësojmë me të gjithë argumentin e të gjithë rrugës, se ai ka një mbështetje nga komuna, ishte zoti Saljani në atë kohë atje, që është bërë e gjithë kjo rrugë prej dy-tre kilometra. Meqë aty njerëzit në tërësi janë larguar dhe nuk prek toka bujqësore, por prek këto ngastrat pyjore, siç edhe e kanë thënë vetë, ka saktësi shumë të madhe, ka pa saktësi shumë të madhe me numrin e parcelave pyjore aty, për të cilin kemi dhe një proces gjyqësor në gjykatën administrative të apelit. Dhe në qoftë se biem dakord që njëherë nuk e miratojmë, të paktën të jemi të logjikshëm, në qoftë se njëherë nuk e miratojmë një komision hetimor, se çështja është në gjyq dhe nuk prononcohemi se na kërkon dokumenta prokuroria për fshatin Velçan, atëherë duhet të biem dakord që edhe kësaj radhe nuk e kalojmë, meqë çështja që e kërkon në gjyq. Unë bie dakord në mbështetjen time personale karshi kryetarit të bashkisë, që nëse kjo nuk na pret dhe duhet ta dorëzojmë sot, hajde ta miratojmë dhe jam dakord ta miratojmë me gjithë parregullsinë. Por parcela pyjore 789 nuk bie në atë vend ku thonë drejtoritë, drejtoria e aseteve. Dhe duke qenë se së fundmi i jeni drejtuar në janar me një shkresë, i nderuar kryetar, i jeni drejtuar Ministrisë së Mjedisit për miratimin e planit të mbashtrimit të ekonomisë pyjore me Mesmal, mbas korrigjimit të shtratit të lumit, atëherë është të na vihet në dispozicion komisionit përkatës, neve si këshilltarë, të gjithë hartografia e parcelave pyjore të fshatit Velçan dhe Selcë, ose të gjithë ekonomisë pyjore, që në rastin konkret përmbledh dy ekonomi pyjore, siç është ekonomia pyjore me smalt dhe ekonomia pyjore Velçan, edhe ekonomia pyjore Strelcë, që përmbledh në vetvete Selcën, se kështu janë të ndara. Mesmali, Velçani shkon me me Mesmalin, Selca shkon me Strelcën. Mbasi t'i kemi të gjitha këto dokumenta, ne bëjmë një gjë tjetër. Marrim një vendim si këshill, që përderisa numri i rrugës që lidh Velçanin me Selcën e ka numrin e pasurisë 753, ne numërojmë me një numër të ri kadastral gjithë rrugën nga Vaskat e Peshkut poshtë te zoti, ku e di unë, si ka pasur Luan Qazimollari që tashmë s'i ka funksionale, deri në fshatin Selcë, të gjithë rrugën. Dhe ndërkohë, kjo pjesë e rrugës, kjo pjesë e rrugës do të kompletojë të dyja gjërat. Nëse s'ka një urgjencë. Nëse ka një urgjencë, hajde ta miratojmë. Por kini planin e mbashtrimit në proces që ministria ju ka thënë duhet ta kaloni në këshill. Atëherë ne sot legjitimojmë një pasuri pyjore 789, të cilën plani i mbashtrimit që kemi në proces, apo do ta kaloni, apo ai që është, nuk e ka këtë numër, ka një numër tjetër dhe krijojmë konfuzion numrash, sepse, më fal një sekondë, Kupja dhe unë në fshat, bashkë me Nersidën, Eglën, apo edhe Verën, po që se do të vijë në shoqërinë tonë, i dimë ku janë kufijtë. Dhe më thoshte ndjesë pas Tan Lamja: "Doktor, janë të ngatërruara punët e pronave. " I kam thënë: "Pronat i kanë ngatërruar letrat, njerëzit i dinë ku i kanë kufijtë. " Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e di a jemi për të njëjtën shqetësim. Do desha ndoshta, se ndaj thirra dhe Andin ta shpjegojmë përse bëhet fjalë, se ndoshta doktori ka të drejtë ose bëhet fjalë për diçka tjetër. Unë me konceptin tim, me atë që di, bëhet fjalë për një aks rrugor i cili nuk ka numër pasurie dhe duhet t'i vëmë një numër. Me kaq, kaq thjeshtë është. Nuk e di a është. Nuk e di sa Andi e ka bërë bashkë, bashkë me këta. Andi e paska bërë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Atëherë. Po, bëhet fjalë këtu për një rekufizim brenda fshatit. Po, jo vetëm brenda fshatit. Velçani është Velçan dhe Selca është Selcë. Kjo është një rrugë që ka qenë në ekzistencë. Se është rrugë e re, domethënë, që e bëjmë ne atë. Atëherë, përderisa kjo rrugë...

Yllson Ibrahimllari: Ajo është një rrugë e bërë në kohën e sistemit të kaluar.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Besoj që po. Fakti që harta është, fakti që hartat janë të vjetra, tregon që është ekzistuese.

Yllson Ibrahimllari:Në kohën e vjetër, im gjysh u dënua me pushkatim. Sot, legjislacioni në fuqi të lejë të më dënosh me burgim të përjetshëm. Kemi ca ndryshime këtu, apo jo? Dikur nuk i binte ndër mend njeri për pronën. Ore, hajde të të jap çfarë ka lënë Batua e Arefiu bashkë këtë terren Velçan, e zgjidhe, po mos bëjmë gjëra që nesër do na hapin problematika. Më ke thënë parcela 789, Andi. 789, thire Klarsenin tani, zotin Brako, dhe më thuaj hartografinë e hartave pyjore të Velçanit.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Tani, për këtë rast, përveç pjesës së hartografisë pyjore, kjo është një rrugë ekzistuese në hartat kadastrale që përdor dhe hipoteka dhe ne, që s'ka emër. Kjo është arsyeja që ne i kemi vendosur.Përveç kësaj, t'i kthehem pak asaj që kërkuat ju me të drejtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shqetësimi është, krijon një problem kjo në qoftë se këta...

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, është problemi shumë i thjeshtë. Ke planin e mbashtrimit që ja ka çuar zoti Brako, ja ka çuar ministrisë. Ministria i ka thënë: "Nuk e miratojmë ne planin e mbashtrimit. Kaloje në këshill." Ne sot juridikisht kemi një plan mbashtrimi që s'e kemi kaluar këtu me votë. Ne tani themi, është ajo fabula e famshme e dikur, e Pllumb Kullës në estradën e Fierit, që tha: "Po mirë, ç'më dënoni mua? Unë litarin e tërhoqa. " Tha: "Po ai që solli lopën? " Tani, më fal, kemi një plan mbashtrimi, s'ka me ty gjë. Ti e ke bërë shumë mirë punën. Plani i mbashtrimit nuk është në fuqi, i nderuar kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Çfarë duhet që ky projektvendim të kalijë?

Yllson Ibrahimllari:Që ky projektvendim duhet kjo gjë, të sjellin pyjorja hartën e vetë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po është brenda fshatit, po themi.

Yllson Ibrahimllari: Po jo, mos ka gjë. Po është parcelë pyjore, zotëri. Ka plan mbashrtimi. Pyjorja të sjellë hartën e vetë, Andi të sjellë hartën e vetë. Përputhen këto të dyja, hajde t'i kalojmë me dy duart. Jo, jo, jo, nuk bëhet me fakt juridik kjo. Ja të ta. .. Ja do të... Po mundohem

të ta shpjegoj, të lutem. Ja, po mundohem të ta shpjegoj pra. Rruga nga shtëpia jote, nga shtëpia jote për te shtëpia e kryetarit është ekzistuese rruga. Por që të ngjitesh dhe të kalosh në... Këtë po mundohem të të them. Në qoftë se doni ta fragmentoni, nuk mund t'i vini rrugës së fshatit Selcë dy numra kadastralë të ndryshëm. Unë po i them për ta bërë të mirë. Po atëherë, që të shkosh këtu lart, o Andi, që nga ngjitesh. Atëherë... Jo, jo, jo, jo, jo. Kjo, më fal, kryetar. Kryetar, më fal një sekondë. Kjo është rruga nga shtëpia jote te njësi administrative Libonik, sikur të vinte drejt. Atëherë, po që unë të vij te shtëpia jote, duhet të ngjit këtë rrugën përpjetë. Unë po të them, merre nga këtu rrugën te shtëpia jote dhe në Libonik vëri një numër. S'po them asgjë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Atëherë, ja të shpjegoj dhe diçka tjetër, doktor. Përveç kësaj situati, vërteta është që ka një numër. Po kemi dy zona kadastrale të ndryshme.Dhe brenda zonës kadastrale, detyrimisht që numri duhet të jetë i njëjtë.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, është në Velçan, numrin kadastral të Velçanit e ke 753. Selcë nuk ke numër kadastral. Ty të duhet numri për Selcën. Atëherë, është të lutem, më fal një sekondë. Atëherë, është të lutem, po mundohem, dëgjo, të lutem, Andi, ti e di që unë i kam të qartat. Si? Jo, jo, s'më kupton. Atëherë, çfarë bën? Do lëmë një numër për Selcën, do vëmë një numër për sa i përket kësaj rrugës së Selcës, ndërkohë që gjithë rrugën e Selcës prej tre kilometrash që çove dhjetë mjetet që e riparove, e ke pa numër dhe pa leje.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Po pra ta bëjmë gati dhe atë...

Yllson Ibrahimllari: Po këtë po them, pra bëje njëherë e mirë.Po, po.Të ketë një ndihmesë. Po dakord, më shiko, e ka për ta bërë. Dakord, më ka një ndihmesë. Dakord, më dakord, po s'mund ta bësh gjysmën me një procedurë dhe gjysmën me një procedurë. E dyta, nuk ka. .. Atëherë, është të lutem, thuaj 789-ta. Nuk ka ngastër pyjore 789 Velçani me miratimin e planit të mbashtrimit të 2021-shit në maj të 2021-shit. Thirre dhe ma gjej.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Po pra, se nuk ka, nuk është në Velçan, është në Selcë. Edhe njëherë, ky është kufiri, këtë isha duke u shpjeguar të gjithëve. Ky është kufiri kadastral që ndan Velçanin nga Selcën.Po pra, po në Velçan e ke 789. 789 e kam në Selcë. Ja ku jemi. Velçani ka 753.

Yllson Ibrahimllari: Ore, më fal një sekondë, i nderuar zotëri, se po sjell krahasim me një gjë që nuk të takon ty. Kishim kryeministrin e nderuar që tha: "Nuk e dua timonin me dy shofera. " Tani ju dy drejtori jeni o burrë, sillini të dy, të dyja programet, sillni dhe pyjoren, sillni dhe kadastrën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Çfarë të thotë, doktor? Çfarë të keqe ka që ne t'i vemi numër pasurie asaj rruge që është për Velçan, për Selcën?

Yllson Ibrahimllari:Për Selcën. Po atëherë, ja më tash, po ta shpjegoj. Jo, mos e shpjego. S'është për Selcën. Jo, lexoje çfarë shkruan. Thotë: "Rruga që lidh Velçanin me Selcën. " Rruga që lidh Velçanin me Selcën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ka një interesim për të ndërtuar një stallë baktish nga një banore në Selcë. Është puna.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Janë në grup banorësh. Po, është punë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe e ka pronën e vet me çertifikatë pronësie. Më dëgjon? Por nuk ka rrugë ku ajo që t'i jepet leja që të dalë stalla. Dhe për t'i vendosur numrin, që të marrë lejën, duhesh e vendosur ky X.

Yllson Ibrahimllari: Po hajde mos t'ia vëmë numrin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kaq është vetëm. Nuk ka lidhje me pjesën tjetër të cilën nuk dua të.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Rasti tuaj, doktor, me sa jam në dijeni unë, me sa jam në dijeni unë, është e drejtoria aplikatëse. Ka filluar, domethënë, të bëjë rehabilitimin e asaj pjesës të rrugës. Besoj që do duhet një pjesë.

Yllson Ibrahimllari: Te cila rrugë?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula:Për rrugën që po kërkoni të të Velçanit. Rruga e re që është e ndërtuar.

Yllson Ibrahimllari: Velçani është me dy rrugë. Njëja e ka bërë unë, njëja e ka bërë kryetari. Velçani është bërë më i madh nga Pojani dhe nga Podgoria.Se ke vënë re ti këtë gjë. Ore, mos ngatërro letrat ti se je në proces gjyqësor me mua.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kaq e thjeshtë është.

Yllson Ibrahimllari: Dakord, mo, do ta bëjmë. Po mirë, më më fal, kur ishte kaq e thjeshtë? Se s'ia tregove Verës, po më mbanje mua sekret..

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e kemi diskutuar as me Ilirin, as me njeri. Po pati një bllokim të një investimi i cili e ka miratuar dhe Ministria e Bujqësisë. Ka kaluar.

Yllson Ibrahimllari: Dakord, Dakord. Hajde mos t'ia miratojmë. Ja tani po ta miratojmë. Jemi të qartë.Të lutem, të jemi të thjeshtë këtu. Dëgjo, nëse nuk do të më dëgjosh mua për Velçanin, të paktën dëgjo Selon. Dëgjo Selon. Se unë nuk e njoh dhe s'dua të gaboj.

Selami Muço:Këtu bëhet fjalë për hyrjen e rrugës deri këtu ku është në hartë. Këtu tregohet pjesa drejt Selcë-Velçan. Bëhet fjalë për hyrjen që nuk është në hartë, që është ndërtuar në kohën kur ishte kryetar Saljani. Kjo është pa numër, se është rrugë e re.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Atë që di unë të shpjegoj është kjo që u thashë pak më parë dhe kam kërkuar nga zyra si zgjidhet që kjo zonjë ta ndërtojë këtë investim në pronën e vet dhe t'i jepet një akses rruge për të nxjerrë baktit.

Selami Muço: Po, ajo në rregull.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe ishte që donte një numër pasurie.

Selami Muço:Bëhet fjalë për numrin e rrugës në hyrje, nga hyrja në lumë deri sipër.

Yllson Ibrahimllari:Bëhet fjalë, Selo, bëhet fjalë për rrugën nga Varrezat e Velçanit, nga bregu i Selcës deri në Selcë brenda. Unë thashë ta bëjmë të plotë. Nuk kisha kundërshtim.

Selami Muço: Me gjithë poshtë.

Yllson Ibrahimllari: Me gjithë pjesën poshtë.

Selami Muço:A, ja, kjo është. Pjesa poshtë nuk është e.

Ornildi Demollari:Për sa kohë që nuk kemi ndonjë lloj mbivendosje apo ndonjë lloj gabim hartografik.

Yllson Ibrahimllari:Të lutem, sillni planin e mbashtrimit të ekonomisë pyjore.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:S'ka problem. Le ta sjellim patjetër. Le ta plotësojmë.

Ornildi Demollari: Ju lutem, ta sjellim. Ta kalojmë në votim.

Yllson Ibrahimllari:Të kishe pasur të njëjtën dashuri për mua si për këtë zonjën, kush e di ku do kishim qenë. Faleminderit.

Petrit Kupe: Nildi.Mua më vjen mirë që kur ka kërkesa nga komuniteti bëhen dhe zgjidhje si kjo puna e ndërtimit të stallës apo të dhe dhënies të tokës me qera dhe nga Selca, më duket sikur qendra e botës po përqendrohet në Velçan e në Selcë. Ndërkohë, më fal, doktor, doktori ka të drejtë sepse i mbron interesat e komunitetit. Ndërkohë, kur ne nga zyra e pronave apo aseteve kemi nevoja të tjera akoma më të nguçme në komunitet, kemi akoma familje të cilat nuk kanë përfituar procesin e legalizimit. Shumë mirë që angazhoheni për këto. Po për këto duhet ndërhyrë zyra e pronave në atë procedurë që ne kemi ngelur.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Nuk është detyrë dhe zyrës së pronave kjo procese, nuk e di.

Petrit Kupe: Jo, më është, është.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Jo, jo, fare, absolutisht..

Petrit Kupe: Kur ti, kur ti si i pronave e ke të palegalizuar ndërtesat e komunitetit, çfarë i shërben ti?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Po drejtoria e pronave është për pronat e bashkisë.Drejtoria e pronave është për pronat e bashkisë, jo të individëve.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në qoftë se duhet një vendimmarrje nga këshilli për këtë, ta bëjmë.

Petrit Kupe: Duhet patjetër.Ai ta bëjë patjetër.Po duhet një, duhet një sforcë nga këshilli.

Yllson Ibrahimllari: Mendoj që t'ju japim konsensusin, mos e pengojmë dhe atë zonjën. T'i vëmë një numër kësaj rruge duke specifikuar për pjesën e rrugës sa i përket zonës kadastrale 32-79 Selcë. Jo për rrugën që është në zonë tjetër kadastrale, siç e shpjegoi vetë zoti Andi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Patjetër, patjetër. Okej.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votimin atëherë, ju lutem. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që është projektvendim për përditësimin dhe saktësimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave dhe saktësimin e kufijve territorial në njësitë administrative, rendi katër dhe kufi fshati rendi pesë. Edhe kjo ka të bëjë me juve, Idlir.

Idlir Limllari: Kjo pikë nuk ishte e hedhur aty në emailin. Nuk kam ide fare për këtë. Nuk ishte, nuk çfarëdo informacion për këtë pikë. Jo, në email jo. Në email jo.Jo, ka ardhur pak më vonë. Në email nuk ishte, në emailin tim.

Ornildi Demollari: Po na shpjego diçka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të shpjego diçka. Kjo ka të bëjë vetëm me sistemin e adresave. Jemi të vonuar. Ka patur disa, të themi, dy-tre fshatra të cilët ndoshta mund të jetë problematikë për të gjithë fshatrat, por nuk ka të bëjë direkt me kufijtë e fshatrave, se s'mund të ndryshojmë kufijtë e fshatrave. Domethënë, nuk mund të veprojë as kryetari i fshatit, as kryetari i bashkisë në vetvete. Këshilli në një moment të caktuar po me vendimmarrje, duke bërë

propozimet përkatëse. Por kjo është vetëm për efekt të sistemit të adresave dhe ne jemi të vonuar për këtë punë që Ministria e Brendshme ta ketë një vendim këshilli për këtë qëllim. Kaq e ka efektin. Nuk ka ndonjë efekt tjetër se po ndërhyjmë në territoret e fshatrave të njëri-tjetrit. Pastaj, nga ana teknike, Andi, ndoshta doktori meqë është marrë më shumë.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem.

Ornildi Demollari: Po.

Yllson Ibrahimllari: Do dëgjojmë kryetarin e komisionit apo e tha? Atëherë, kjo dhe në tërësi problematika me kufijtë e fshatrave është një problematikë që ne duhet t'i shkojmë për ta zgjidhur njëherë dhe në mënyrë definitive. Këto që na janë dërguar kanë parregullsi të mëdhaja, por ndoshta ne nuk i kemi kompetencat ligjore për t'i ndryshuar ato. Zona kadastrale 37-27 që i përket fshatit Velçan, andej nga vij unë, ka një pjesë të madhe të pasurive të veta të pafutura brenda zonës kadastrale dhe ka një mospërputhje midis zonës kadastrale dhe pjesës hartografike të zonës kadastrale dhe hartës 1 me 5000 të ndarjes së tokës nga Qarku, harta 1 me 5000 e vitit 1990, në bazë të ligjit 19-7501 të datës 19. 07. 1991 me vendim të parlamentit. Unë mendoj që ne si këshill, sa fshatra kemi ne si bashki kryetar, kemi nja 80 e ca. Në qoftë se unë besoj që një fshat ka katër kufij, siç ka gjithmonë gjeografia. Në qoftë se një këshilltar do të merrte përsipër që të uleshe me dy njerëz të dy fshatrave me kryetarët dhe të shkonte të bënte një takim me fshatrat, do të ishin saktësuar për sa i përket ca objeksioneve në të ardhmen me që dalin këto problematika të cilat, në dukjen e parë, duken si hiç asgjë, por në fakt mund të sjellin konflikte të mëdha. Një nga konfliktet është që mund të arrestosh kryeplakun e fshatit tjetër për mbjellje kanabis nga një fshat tjetër në zonën kadastrale, se për aq i kemi kthyer kryeplejtë. Se për mua, në qoftë se do kemi ndonjëherë demokraci dhe ligj që do funksionojë në këtë vend, duhet të jetë kryetari i fshatit me kompetenca siç i takon dhe siç ka qenë që moti. Nisur nga kjo, në zonën kadastrale që të thashë, ka këtë. Ka kufij të tjerë që pjesa e Strelcës shkon deri në kufi me Gramshin, Mesmalin shkon, po ndërkohë fshati Selcë dhe Velçan, që kanë dhe pasuritë më të mëdha të kullotave, nuk janë aty. Kemi dhe një gjë tjetër që ne nuk mund ta themi kaq kollaj pse ndodh kështu dhe pse bëhen, sepse kemi dhe aplikime tashmë te paketa e maleve. Pra, një pronë që i takon, i takon fshatit Velçan, në fakt është dikush atje te cepi ku shkove, që pe rrugën e Mesmalit, që ka bërë një ndërtim që është toke Velçanit, ndërkohë ai është nga Strekajni, ka marrë, ka aplikuar, do shikohet legjislacioni, nuk po i hyj anës teknike, ta marrë etj. Atëherë, problemi qëndron këtu te kjo që kemi. Ne, unë mendoj që, duke angazhuar dhe këshilltarët, sa të jetë e mundur, e të tjerat, ne të përafrojmë, të dalim me një objeksion, të dalim me një diskutim ku janë kufijtë natyrorë të fshatrave. Që Podgoria mos nxirret me Zvezdën për kullotat që ju i njihni shumë mirë. Dhe besoj që, nëse kjo do të miratohet për sa i përket adestrarit, hajde ta miratojmë, meqë jemi dhe të vonuar në këtë fushë, por këshilli duhet të ketë parasysh me dy drejtoritë përkatëse që ne t'i nxjerrim, t'i paraqesim si problematika që ka, që ne ta dimë konstatim dhe pastaj institucionet përkatëse i marrin parasysh çfarë themi ne apo si marrin, që mos vijë pastaj te ndarja e kryeplakut të fshatit Drithas, lart e poshtë, e poshtë e lart e e lamë siç ishte. Po ç'ke me mua, më? Faleminderit.

Ornildi Demollari: Mbarove.

Yllson Ibrahimllari: Faleminderit.

Ornildi Demollari: Po, Idlir.

Idlir Limllari: Meqënëse jemi në kjo pikë kryetare dhe kisha një si propozim, numrat e shtëpive do vihen ndonjëherë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo për të cilën, kjo për të cilën po flasim, ka të bëjë, është hapi i parë të cilin Ministria e Brendshme e ka marrë disa herë dhe nuk e ka filluar, pasi edhe ne kemi dashur të jemi edhe financues të kësaj pune, të kontribuojmë financiarisht, edhe ajo ka një kosto financiare, si tabelat e rrugëve, si numrat e shtëpive, të banesave etj. Ndaj dhe duhet bërë një, një njësim kombëtar, edhe që mos ketë njëra bashki i bën numrat ndryshme apo tabelat, ndaj dhe po ecet në këtë linjë dhe jemi të vonuar në rang Shqipërie. Nuk është se është vetëm Maliqi në këtë pjesë. Të jetë vetëm për adresarët, kjo që po marrim si vendimmarrje, le të ecim me ato problematika që mund të kenë kufijtë e çdo fshati. Unë jam shumë dakord dhe ndoshta zyrat, specialistët e zyrave edhe të pronave edhe të urbanistikës duhet të na, duhet të na saktësojnë si veprohet në qoftë se një kufi, një fshati nuk është mirë. Si veprohet për të vajtur tek reali, tek realja? Si veprohet? Kush e ka të drejtën, kush e miraton, ku e çon, si vepron, çfarë procedurë? Se nuk besoj se është kaq e thjeshtë. Pasi kufijtë e bashkive janë bërë me vendim qeverie. Kemi patur problematika midis bashkive kufitare me njëra-tjetrën, janë ngritur grupet e punës, kanë gjetur një të mesme të përbashkët, jo se po ndanim kufijtë e njëri-tjetrit, sesa po ndaheshin kufij midis, ta zëmë, Korçës me Pogradecin apo me Gramshin, apo Maliqin me kufitarët e vet. Dhe është gjetur një e mesme dhe është ka dalë vendimi i qeverisë përfundimtar që ka ndarë kufijtë përfundimtarë të bashkive. Po flasim sot se mund të ndodhë që me ndarjen e re administrative mund të ketë ndryshime, nuk e dimë. Megjithatë, kjo e fshatrave, unë mendoj, le ta miratojmë këtë për efekt adresari të adresave, të shkruajtur si nocion për këtë qëllim dhe ndoshta le të ketë një pikë Drejtoria e Pronave e Urbanistikës në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave, me këshilltarët, të marrin një nismë për efekt të problematikave që mund të ketë mbi kufijtë e fshatrave, të cilat i njohin mirë edhe të moshuarit, ndoshta edhe ata të cilët kanë jetuar nëpër këto fshatra.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kryetar. Kemi gjë tjetër. E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 21 vota pro miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 13 e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në bashkinë Maliq.

Pranvera Begolli:Përshëndetje, kryetar. Komisioni i rregullores së ligjit dhe administrimit u mblodh sot për të parë atë, por unë di të them që për këtë rregullore që na u paraqit, aktualisht

është bërë dëgjesa dhe për fat të mirë unë kam qenë në atë dëgjes, ku ishin aty dhe përfaqësues të komunitetit dhe përfaqësues të firmave pastruese dhe të tjerë. Kështu që mendoj që është një rregullore që është në dispozicion të komunitetit, duke i sensibilizuar, duke i ndarë gjërat, duke mos sjellë probleme në mbetjet që ne hedhim nga të gjithë qytetarët, apo dhe nga bizneset. Dhe jam me atë që aktualisht kjo rregullore duhet të miratohet.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër? E kalojmë në votim, apo do shtosh diçka, kryetar, te kjo pjesë? E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet me 21 vota pro. Faleminderit. Kalojmë tek pika 14 e rendit të ditës, që është zgjedhja e përfaqësuesit të këshillit bashkiak Maliq për këshillin e Qarkut Korçë, pas vakancës së krijuar.
Pranvera Begolli: Meqënëse jam përsëri te komisioni i ri, aktualisht neve, dhe komisioni rregullore e mandateve, ne e bëmë takimin sot në mëngjes edhe qeverisë së mirë, se dakort ju. Për momentin, derisa nga vetëm nga opozita është paraqitur një emër i këshilltares Egla Baliu, mendoj që, mendoj, ky është një mendim i imi, që të bie me konsens përbashkët që të kemi një përfaqësues, sepse nga opozita nuk ka asnjë përfaqësues. Megjithatë, votimi është i lirë. Çdo këshilltar ka të drejtë të votojë ose të propozojë dhe ndonjë emër tjetër. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Pra, kemi vetëm një propozim nga grupi i opozitës, nga këshilltarët e grupit të opozitës, që është zonja Eglantina Balli. Po?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë do isha dakord që të kemi një përfaqësim nga opozita. Më vjen mirë që është propozuar zonjë, zonjushë, zonjë.

Ornildi Demollari: Po ishte dhe, ishte pak e përcaktuar ajo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, patjetër, patjetër. Patjetër, po ecim në këtë linjë, duhet të ishte një vajzë, një zonjë nga grupi jonë, nga. .. kështu që më vjen mirë që ka një konsensus dhe unë e mbështes edhe i uroj mbarësi në qoftë se këshilltarët do ta votojnë.

Ornildi Demollari: Atëherë, s'ka nevojë për votim të fshehur, të mbyllur, sepse është një kandidaturë. E kalojmë me konsensus edhe në votim njëkohësisht. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Yllson Ibrahimllari: Unë dua t'ju falenderoj që mbajtët pjesën e propozimit tonë dhe kështu siç duket bëheni dhe bashkia shembull në nivel Qarku, që keni një vend nga opozita. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, zonja Eglantina. Suksese dhe punë të mbarë në këshillin e Qarkut Korçë.

Eglantina Balli: Shumë faleminderit të gjithëve për mbështetjen. Punë të mbarë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Atëherë, kalojmë tek materialet që na erdhën së fundmi. Nga Drejtoria e Kulturës, projektvendim për aktivitetin kulturor verë dhe portokalle.

Pranvera Begolli: Mendoj se këto janë aktivitete që kanë qenë në ndihmë të komunitetit, aktivitete që e kanë gjallëruar qytetin. Besoj se asnjë nga këshilltarët nuk do ketë ndonjë kundërshtim që këto aktivitete, për mua, të gjitha pikat, dhe më vjen mirë që Drejtoria e Kulturës ka nxjerrë dhe një për emigrantët. Bravo! Që është një risi e re. Kështu që unë mendoj që të treja këto projektvendime të miratohen radhë pas radhe.

Ornildi Demollari: Po, jo me radhë, me radhë. Ka ndonjë gjë tjetër? Me radhë. Po.

Yllson Ibrahimllari: Pa ju ndërprerë gjatë. Jemi dakord për t'i miratuar. Po besoj të shkojmë çik te këto prodhimet tradicionale, se portokalli në Maliq nuk bëhet. Qershitë mirë i kishin në Kolanec.

Ornildi Demollari: Emërtimi, ashtu? Emërtimi.

Yllson Ibrahimllari: Qartë, qartë, qartë. Prandaj po ndihet një gjë që ka një frymë gjallërimi i jetës kulturore në Maliq. Tani ju vijnë dhe piktorët. Pastaj mbledhim dhe komisionin e titujve nga shtatori. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë ju falënderoj të gjithëve që bëni. Dua t'ju jap vetëm një informacion. Kam filluar tashmë kurset në Pallatin e Kulturës dhe po ju them, deri tani janë regjistruar 160 fëmijë, por 50 janë në pritje se nuk kemi ku i çojmë. Llogariteni cili është impakti që ka dhënë dhe e mora fjalën për të bërë një apel për të gjithë prindërit e bashkisë Maliq që t'i sjellin më mirë në Maliq, tek qendra jonë, ku efektivisht kemi filluar pa asnjë lloj pagese dhe pagesat në momentin që do të fillojnë, që do ta vendosim bashkërisht, do jenë minimale për efekt të mbështetjes së këtyre familjarëve të cilët duan t'i zhvillojnë fëmijët me kurse të ndryshme, t'i largojnë nga lokalet, t'i largojnë nga, ku di unë, nga ambientet jo. Nga ku di unë dhe të marrin një zanat, të themi se është shumë pozitiv.

Yllson Ibrahimllari:Në mbështetje të fjalës tuaj, besoj që familjet që marrin asistencë duhet të kenë përjashtim nga kjo gjë. Ndërkohë që besoj që në atë që do të vini si tarifë, edhe fëmijët e këshilltarëve që të japin shembullin e vet, duhet të jenë aty prezent. Jo, jo! Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Ju lutem, e kalojmë në votim projektvendimin verë dhe portokalle. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek projektvendimi tjetër, projektvendim për aktivitetin kulturor "Festa e Madhe e Kengës".E kalojmë në votim, ju lutem? Kush është dakord?21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek projektvendimi tjetër për miratimin e fondit për zhvillimin e aktivitetit kulturor "Netët e Mallit".

Pranvera Begolli: Kjo është një risi e re për emigrantët dhe është gjëja më e mirë që bëhet..

Drejtore e Kulturës; znj.Dhora Shkembi: Mirë, së pari shumë faleminderit. Ju kërkoj edhe shumë ndjesë që këto projektvendime i sollëm pak me vonesë, por kemi pasur të merrësi shumë ngarkesë për arsye se duam të ndryshojmë kalendarin vjetor të aktiviteteve dhe të mos jetë ashtu siç ka qenë, në mënyrë që edhe qytetarët e banorët e bashkisë Maliq të kenë një qasje tjetër. "Netët e Mallit" erdhi si ide nga unë për të gjithë ata që na shkruanin, po për ne, po për ne, po për ne, çfarë do të ndodhë në Maliq, duke qenë se gjithnjë shohin aktivitete në bashkitë e tjera. Edhe do të jetë e ndarë në dy netë. Nata e parë do të jetë kthim në tingujt e dikurshëm, muzikë qytetare shqiptare që na kthen në shtëpinë e gjysheve dhe të tjerë, të tjerë. E nata e dytë do të jetë me muzikë tradicionale shqiptare, folk. Do të bëhet përpara shtëpisë së kulturës, një oborr fantastik. Kemi menduar edhe se si do ta dizajnojmë, kështu që ju falenderoj shumë të gjithë këshilltarët që e miratuan, sepse të treja projektet janë shumë të bukura.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Atëherë tek kemi dhe "Netët e Mallit" për ta kaluar në votim. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet dhe kjo. Faleminderit.
Yllson Ibrahimllari:S'kisha këtu. Kjo është një nga arsyet që duhet të diskutojmë në ora 5:00 pasdite për në takimin, dëgjessën publike, për ndarjen e re territoriale, pse bashkia Maliq duhet të ekzistojë. Falë edhe kulturës dhe ritmeve të reja që keni bërë. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Atëherë ecim. Jemi tek materiali për titujt e nderit, ku nga komisioni i titujve të nderit ka erdhur një, i cili u mbyll para dy ditësh, tre ditësh dhe erdhi një material. Por do desha ta veçonim disi materialin, pasi kemi disa emërtime objektesh dhe disa emra për tituj nderi. Tani, duke qenë se tek titujt e nderit ne nuk e kemi miratuar akoma rregulloren dhe ndërkohë që të gjitha bashkitë, pothuajse të gjitha këshillat bashkiakë e kanë pezulluar këtë si procedurë, pasi janë në pritje të një miratimi të një VKM-je, do desha që këtë material ta ndajmë pak, të miratojmë vetëm emërtimet, që është emërtimi i shkollës në Çaushli, emërtimi i qendrës shëndetësore në Sheqeras dhe titullin e nderit për këtë mësuesin e Lozhanit, i cili ndërroi jetë. Këtë mendim kam unë. Pastaj këshilli si ta mendojë. Po?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë kam qenë në nderin e komisionit edhe bashkë kishë përfaqësues edhe të opozitës. U diskutua, u diskutuan katër emra edhe dy emërtesa institucionesh. U debatua për forma të ndryshme për mënyrën për titujt, për rregulloren, për

vendimin e qeverisë. Edhe në fund u ra dakord që të kalohen. Nuk e di a e kam materialin këtu për këtë, sikurse po e shikoj ta kem, materialin e. Rasti.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ma jep pak. Domethënë, shkolla e mesme e Gorës, e Lozhanit të Ri, ka dhënë, ka bërë një propozim për dhënie tituj për mësuesin Albert Beleri, i cili u ndërroi jetë në krye të detyrës, edhe një apel për të, për punën e tij, a e i po harruar qoftë, dhe i gjithë komisioni ishte dakord, s'pati asnjë. Propozimi i dytë ishte për vendosjen e emrit të shkollës "Shqitas" dhe nga komuniteti i fshatit Sheqeras kishte ardhur një propozim për të vendosur dhënien e titullit. Këtu thotë dhënie titull, por aty është vend vendosjen e emrit të qendrës shëndetësore të infermierit Oliver Meroi, i cili dhe ai u ndërroi jetë, një infermier i përkushtuar, etj. Edhe kjo u miratua me vota të plota. Për shkollën "Shqitas" kishte ardhur një propozim për t'i vendosur emrin e mësuesit Ali Gjata. Edhe ky një mësues i nderuar, i cili. ..

Yllson Ibrahimllari: Ky titull Ali Gjata nga komisioni ka ardhur me kontestim, nga komisioni i verifikimit?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, ka ardhur okej. Nuk kishte asnjë problem. Tani, organizata e veteranëve për ta bërë prezent dhe pasardhësit e veteranëve të LANCH-it ka bërë dhe propozim për tre emra, i cili është Islam Kondi, Filloreta Zaçe edhe Natasha Gjylameti. Për të cilat u debatua, u diskutua edhe komisioni vendosi që Islam Kondi t'i jepte titullin "Qytetar Nderi". Bile propozimi i direkt ishte i këshilltarit të opozitës, pavarësisht se ne, se Islami ka marrë një vendim nga këshilli i bashkisë Maliq, siç u shpjegua nga Drejtoria e Kulturës, dhe s'mund të jepnim ne dy tituj kur ne ja kishim dhënë një. Dhe u bë ky propozim dhe kaloi aty. Edhe Filloretën që ju e njihni, pavarësisht se e thamë që ka konflikt interesi dhe s'mund të, edhe Natasha Gjylameti, i cili dy aktiviste të themi për punën që bëjnë në organizata e veteranëve, pasardhësve të familjeve dëshmorëve të LANÇ-it e tij. Këto kanë qenë ajo çfarë u diskutua në komision dhe komisioni në konceptin e tij ka diskutuar dhe ka vendosur, meqenëse me ligjin e ri të dhënies së titujve, ndoshta kjo ishte mbledhja e fundit e atij komisioni, se ndryshon koncepti, ndryshon rregullorja, ndryshon mënyra se si do të veprojë me vendimmarrjen e re që tashmë është miratuar në legjislacion, por jo në vendimin e këshillit të ministrave, se vendimi i këshillit të ministrave them duhet të dalë brenda 10 ditësh, dy javësh. Dje kemi kaluar në këshillin konsultativ në Tiranë, ku kam qenë prezent. I kam miratuar dhe ia sjell këshillit, pastaj ndarja që mund të bëni është e drejta juaj, por unë dua të sjell opinionin që isha vetë në komision dhe dua ta sjell këtu. Kaq dua të shpjegoj. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Nuk e di, unë gjykoj që unë vetë, pastaj gjykoj që ne duhet ta ndajmë këtë material dhe të presim VKM-në, pasi di të them që një pjesë e madhe e këshillave bashkiake e kanë pezulluar këtë proces për dhënien e titujve të nderit, por jo për emërtimet. Dhe gjykoj që dhe ne duhet të ecim në këtë lloj llogjike. Po?

Yllson Ibrahimllari: Tani na vini në vështirësi se kemi zonjën Zaçe këtu. Unë besoj siç ka ikur si procedurë të shkojë edhe për këta që janë edhe ta presim atë VKM-në, se duket se tani i vetmi

propozim që na vjen nga një anëtare e këshillit, ne të bëjmë refraktaritetin këtu, të gjendet mundësia ligjore siç është gjendur për të tjerët, siç i kemi miratuar të tjerët edhe parregullore prezente, edhe të mbyllet kjo histori duke pritur VKM-në. Në qoftë se ka pengesa ligjore, të shprehet juristi pastaj. Unë s'jam tek ajo pjesë. Për sa i përket dy emërtimeve të shkollave, biem dakord në pjesën që i keni dhënë edhe infermieri ndjesë pastë. Problemi qëndron që kryetar, ta kam thënë me mijëra herë, kemi pasur nënkryetarin e Republikës Autonome të Korçës. Veri një shesh ka ajo babienji në këtë qytet, një emërtim, se na nderon të gjithëve si figurë unifikuese. Nuk doli dot partizan, po s'kemi ç'i bëjmë, ishte përpara kësaj historie. Faleminderit.

Petrit Kupe:Më fal, Nildi.

Ornildi Demollari: Po, Petrit.

Petrit Kupe: Unë jam dakord për ato emërtimet që keni menduar dhe atë logjikën që thoni dhe ju. Ta ndajmë këtë, sepse ka dhe figura të tjera të propozuara. Më fal, zotëri. Ka figura të tjera të propozuara të cilat do të shqyrtohen në kuadrin e vendimit të këshillit të ministrave. Për ato jam dakord, ndërsa dua të kujtoj bashkinë, aty në Dritas është bërë një fushë sportive dhe fushë e mirë. Aty ka një vendim të këshillit të komunës së të Libonikut me një emërtim: fusha sportive "Myzafer Mero". Ndoshta është momenti që të vendoset edhe ky, edhe kjo kujtesë, përpara fillimit të aktivitetit të kësaj fushe. Kaq kisha.

Ornildi Demollari: Faleminderit, po.

Fevri Sherifi: Vlerësimi që i bëhet këtyre figurave dhe ne jemi dakord që të vlerësohen tamam ashtu siç meritojnë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë mendim tjetër? Atëherë kaloj. Unë jam për emërtimet vetëm, pastaj për titujt e nderit presim doktorin e zbutit tani, e ka.

Yllson Ibrahimllari: Doktori, as e drodhi doktorin, mos fol fare. Kam një bar tjetër më të madhe sesa kaq. Lola është infermiere, unë jam mjek.

Ornildi Demollari: Dakord, më dakord.

Yllson Ibrahimllari: Edhe po s'mbrojta sojën e llojin tim unë, është. Lola nuk do votonte kurrë për mua, po unë do votoj pro Lolës. Kështu që mbaheni në partitë, shtrëngojeni rreshtat, por unë jam për t'i dhënë.Tani një këshilltare kemi, s'ka kuptim gjithë jetën e vet infermiere.

Ornildi Demollari: Unë jam për emërtimet vetëm dhe titujt e nderit presim dhe pak kohë të dalë VKM-ja dhe pastaj prapë, prapë këtu jemi. Do të bëhet me këtë këshillë ajo, patjetër. Atëherë për emërtimin e qendrës shëndetësore në Sheqeras dhe emërtimin e shkollës së Shqitasit, kush është dakord?

21 Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka, miratohet. Faleminderit. Ndërsa pjesa tjetër pastaj ngelet edhe Sheqerasi, të dyja, Sheqerasi dhe Shqitasi. Po shkolla Gore është titull nderi. Emërtimi i shkollës është?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, jo, jo, është një krenari, mirënjohje.

Ornildi Demollari: Një standard, një standard për emërtimet. Është titull nderi. Është titull nderi, pas vdekjes. Presim pak se nuk sa të dalë VKM-ja. Besoj.

Yllson Ibrahimllari: Unë në fakt do të isha për emërtimin e një nga shkollave rreth e qartë me emrin e tij. Pavarësisht se ai është, do ishte me mijëra, do të jepte një ngjallje motivimi për arsimtarët e rinj, etj. Të shihet kjo mundësi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Vetë propozimi i ndërmarrjes së shkollës së Lozhanit?

Yllson Ibrahimllari: Po, ta gjejë ajo një nga shkollat aty që ka sipas varësisë. Një shkollë në Lozhan. Ka dhe tetëvjeçare përveç të mesmes, e dini ju si është.

Ornildi Demollari: Atëherë miratohet emërtimi i shkollës nëntëvjeçare në Shqitas "Ali Gjata" dhe qendra shëndetësore në Sheqeras me emrin e infermierit të ndjerë Oliver Mero.Oliver Mero. Faleminderit, këto ishin materialet, ndërkohë tek diskutime të tjera kemi dhe një kërkesë për shqetësimet e fermerëve për sa i përket problemit të përmbytjes, ku në sallë kemi thirrur përgjegjësin, e drejtorin e agjencisë.

Almir Elezi: Nildi.Mund, meqenëse e ngrita unë si çështjen e grupit, unë në datën shtatë qershor e kam bërë atë foto, kam qenë në mal edhe siç duket janë të paktën 300 hektarë tokë sot që janë nën ujë. Edhe fermerët nuk kanë mundësi t'i mbjellin me as, e kupton, nuk diskutohet. Jo vetëm ato, por edhe më shumë, sepse është tokë që nuk mban mjetet bujqësore.Edhe duam të dimë për shpërblimet e përmbytjeve.

Ornildi Demollari: Shpërblimet nuk i bën bashkia më.

Almir Elezi: Po ç'rëndësi ka, premtovi drejtori që shumë shpejt do t'i dëmshpërblejmë fermerët për përmbytur.

Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari:Përshëndetje, më vjen mirë që ka kërkesa të këtij lloji në sektorin e bujqësisë për të, duke na dhënë mundësinë për të sqaruar disa gjëra që duhen sqaruar. Premtime nga sektori i bujqësisë nuk besoj se ka pasur, sepse nuk është kompetencë. Megjithatë, po ju sqaroj diçka. Procedura e regjistrimit të dëmeve sipas kulturave për çdo familje ka përfunduar. I gjithë informacioni i përmbledhur është përcjellë në institucionet përkatëse. Që nga ai moment jemi në pritje të një përgjigjeje për dëmshpërblimin e fermerëve të cilët ne si bashki e kemi kërkuar vazhdimisht, jo vetëm një herë. Ky informacion është, siç e

thashë, i hartuar me procesverbale në bashkëpunim me kolegët e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe kjo procedurë ndoshta, ndoshta mund të zgjasi disa kohë, sepse dëmshpërblimet nuk është se sipas historikut të dëmshpërblimeve nuk është se kanë ndodhur brenda dy muajsh apo brenda një muaji, se është një procedurë që zgjat. Institucionet përkatëse që janë në dijeni të kësaj janë Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Bujqësisë, Prefekti i Qarkut, të gjitha, të gjitha procedurat janë ndjekur. Edhe informacioni që përmendi zoti këshilltar është përcjellë për 300 hektarë e diçka më tepër që aktualisht është nën ujë dhe për këtë vit bujqësor nuk do të mund të mbillet. Bashkia ka marrë një masë sipas kompetencave. Ky këshill ka vendosur që të lehtësohet barra fiskale, tatimet në masën 70% për familjet të cilat kanë tokë në ato parcela dhe nuk do ta mbjellin për këtë vit. Ndonjë informacion tjetër në qoftë se do të dëshironi. Jam i gatshëm.

Ornildi Demollari: Po, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shqetësimi është i drejtë, është edhe shqetësimi jonë. Edhe unë e kam çuar këtë shqetësim deri tek kryeministri. Ai ka dhënë porosi ministrave përkatës për ta parë me seriozitet dhe me, dhe unë mendoj dhe shpresoj që muaj qershor që jemi tani mund të ketë një akt normativ të qeverisë kur mund të trajtohen edhe rastet e përmbytjeve. Shmang një vendim qeverie që është dëmshpërblyer blektori që ju dëmtuan bagëtitë në Shkozë. Edhe pse ne e kemi dëmtuar, kemi ndihmuar diçka, po tashmë e ka dëmshpërblyer edhe Ministria e Bujqësisë për atë rast, i cili ishte i rasti i vetëm, të paktën në bashkinë tonë. Të shpresojmë që akti normativ i qershorit të gjejë përfshirje edhe për të përmbyturit e zonës sonë, të cilët nuk janë pak. I gjithë dokumentacioni që tha drejtuesi i bujqësisë të bashkisë është i vërtetë. Ne kemi çuar, kemi çuar disa shqetësime, jemi duke e ndjekur si problematikë. Është edhe shqetësimi jonë i drejtpërdrejtë. Kështu që na takon ne si institucion, mua patjetër për ta ndjekur në të gjitha hallkat dhe për të bërë presionin e duhur në thonjëza që ky dëmshpërblim të ndodhë, pasi ata fermerë aktualisht sot nuk mbjellin dot. Nuk është se u lirua, e po tani mund t'i dhe, por mbillni. Ose edhe atyre që u janë dëmtuar prodhimet dhe i kemi përfshirë të dy pjesët, edhe ata që ju dëmtuan prodhimet, por edhe ata të cilët kanë tokat përmbytur, apo jo? Kështu që jemi duke e ndjekur dhe do të mbajmë këshillin në korrent për çdo situatë që do të ndodhë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër? Tek të ndryshmet, po.

Yllson Ibrahimllari: Po, tek të ndryshmet. Unë besoj që nuk jemi ndonjë qytet i madh industrial, sa netë na vite të ndryshmet, pavarësisht nga propozimi e tjera. Duhet të ishte futur në rendet e ditës ky sqarim, mund të gjendej shenjë pikë. Nga mbledhja e ardhshme dhe në vazhdim, brenda të gjitha kompetencave të ligjit e të rregullores, unë në emër të grupit do të hartoj një kalendar të interpelancave me drejtoritë e ndryshme në varësi ose jashtë varësisë, me komisariatin, me zyrën e aftësisë së kufizuar në pranë, me drejtorin e ujësjellësit, nëse do jetë e nevojshme. Çfarë na jep ligji dhe do kemi një kalendar, t'ia çojmë komisionit dhe një nga drejtorët që është aty, kalendarin gjejeni vetë, bëheni vetë. Unë përgjithësisht nuk i pëlqej këto interpelancat në nivel drejtoresh, se i dua gjithnjë me kryetarin e bashkisë dhe kështu më pëlqejnë, por në rastin

konkret për t'i informuar më mirë banorët, siç edhe e thoni, do të ishte më e vlerës. Kalendari do jetë i dorëzuar tek sekretari. Rregullorja e ka dy muaj përpara, duhet thënë, kështu që bëjmë një kalendar vjetor deri në mbylljen e mandatit, sa të thonë rrëmon këtej e rrëmon andej, doktori më mirë të rrëmojmë drejtpërdrejt. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit shumë, doktor. Kemi gjë tjetër tek të ndryshmet, po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ka qenë një praktikë e këshillave të mëparshme ku këshilli thërriste në raport drejtues apo përfaqësues të institucioneve të cilët japin informacion për arsimin. Po, po, për arsimin, për shëndetësinë, për bujqësinë, për çdo gjë, kështu që mua më duket.

Ornildi Demollari: Kemi gjë tjetër tek të ndryshme, nuk kemi. Ju lutem të mos largoheni, pasi kemi.

Yllson Ibrahimllari:Më fal, se s'më le vera. Në orën pesë është takimi për reformën territoriale. Nga grupi i opozitës kemi bërë një rezume të gjërave, pse ne mendojmë që bashkia e Maliqit duhet të ekzistojë për të mirën e komunitetit që ne përfaqësojmë. Besoj këtu do jemi në një linjë, me kryetarin e kemi biseduar. Dje, me porosi të kryetarit, jam telefonuar nga nënkryetari i bashkisë, me të cilin kemi rënë dakord për prioritetet me shërbim të të gjithë komunitetit. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Atëherë këtu e mbyllim mbledhjen e këshillit të bashkisë, kjo ishte mbledhja ditë të mbarë.Faleminderit!

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI